

# Kornizë për përdorimin e ekraneve në shkollë dhe këshilla për në shtëpi

Edukimi dixhital është në një fazë eksperimentale në kantonin e Vaud. Në pritje që ai të pajisë secilin nxënës më aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për një përdorim të arsyeshëm të pajisjeve dixhitale, ja cila është **korniza shkollore** e propozuar dhe disa **këshilla për të mbështetur prindërit**.



Pajisjet dixhitale personale te nxënësve, siç janë **telefonat mobilë**, ekrantet dhe pajisjet e tjera elektronike, janë **të ndaluara brënda territorit të shkollës** gjatë kohës së mësimi. Megjithatë, përdorimi i tyre është i paraparë gjatë aktiviteteve pedagogjike të mbikqyruara nga mësuesi-ja.

Shkollat bëjnë projekte parandaluese dhe edukuese në lidhje me përdorimin e ekraneve.

Jashtë shkollës, bisedoni me familjen tuaj **për të vendosur rregulla** se si duhen përdorur ekrantet në mënyrë që të ketë një përdorim të arsyeshëm të tyre.

Bisedoni herë pas here për to. Gjatë diskutimeve tuaja, përfshini edhe aspektet si koha, kostoja, vëndet dhe lloji i ekraneve të përdorura.

Nëse rregullat a parashikuara për fëmijët nuk vlejné edhe për të rriturit, të rriturit duhet të jenë të kujdesshëm për rolin e tyre si shëmbull.

Në rast mosrepektimi të kësaj kornize, mund të parashikohen edhe dënime. Megjithatë, **mundohuni të mos ndaloni gjithçka**, sepse ndalesa e përdorimit të një telefoni mobil ose i internetit do të thotë ta privosh fëmijën nga marrja e një dije dhe një përkatësie shoqërore themelore.



**Respektimi i kufizimeve të moshës** në relacion me përmbajtjen e programeve e mbron fëmijun tuaj. Në mungesë të një kufiri të qartë, përzgjedhja bashkë më fëmijën mund të jetë një zgjidhje e mirë.

Mosha e lejuar për përdorimin e shumicës së **rrjeteve sociale dhe mesazheve** është 13 vjeç. Midis moshës 13 deri në 16 vjeç, i rrituri mund ta shoqërojë të riun ose të renë.

Nga mosha 4 deri në 9 vjeç, çdo aktivitet në një ekran shoqërohet nga një i/e rritur.

Nga mosha 4 deri në 9 vjeç, çdo aktivitet në një ekran shoqërohet nga një i/e rritur.

Që në moshën 13 vjeç, fëmija mëson të jetë i pavarur në veprimet e tij në ekrane.

**Shkëmbeni së bashku** se çfarë sheh dhe bën fëmija në ekrane. Kështu përfitojnë i rrituri dhe fëmija!

**Kufizojeni kohën e zbatimjeve përpara ekraneve** dhe përshtateni atë në varësi të moshës së fëmijës. Më shumë se 2 orë në ditë përpara ekraneve, kosiderohet e tepruar.

**Fiksoni orët kur duhet të shkëputeni** prej ekraneve, në mbrëmje si dhe në mëngjes.

Përcaktoni **vëndet pa ekrane**, për shëmbull në tyezën e ngrënjes dhe në dhomën e gjumit.



Nëse përdorimi i pajisjeve elektronike bëhet sipas rregullave, një bashkëpunim i mirë shkollë-familje u mundëson fëmijëve **të zhvillojnë aftësitë e tyre numerike** dhe të përfitojnë **në shumë aspekte pozitive të aktiviteteve në ekrane**. Kërkimet në internet rrisin njohuritë dhe zhvillojnë të mënduarit kritik, programimi strukturon të mënduarit, lojërat video zhvillojnë kërkimin e zgjidhjeve dhe koordinimin, rrjetet sociale stimulojnë të kërkuarit dhe përkatësinë shoqërore.

